



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2023:008197  
Datë: 30.05.2024  
Numri i dokumentit: 05756104

Pml.nr.300/2024

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Afrim Shala, kryetar, Agim Maliqi dhe Rasim Rasimi, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit Gj. M., për shkak të veprës penale mashtrimi nga neni 323 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit, kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm P.nr.17/2023 të datës 17.05.2023 dhe aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës- Departamenti i Përgjithshëm PA1.nr.1085/2023 të datës 20.03.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më 29 maj 2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit Gj. M. e paraqitur kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm P.nr.17/2023 të datës 17.05.2023 dhe aktgjyqimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës- Departamenti i Përgjithshëm PA1.nr.1085/2023 të datës 20.03.2024.

**A r s y e t i m**

## **Vendimi i Gjykatës Themelore**

Gjykata Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin P.nr.17/2023 të datës 17.05.2023, të dënuarin Gj. M. e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale mashtrimi nga neni 323 par.1 të KPRK-së, dhe e ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) viti dhe me dënim me gjobë në shumë prej 400 (katërqind) €. I dënuari është obliguar në pagesën e shumës prej 30 €, në emër të paushallit gjyqësor dhe shumën prej 20 € në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit, kurse i dëmtuari për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

## **Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës**

*Gjykata e Apelit e Kosovës* - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin PA1.nr.1085/2023 të datës 20.03.2024, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarit kurse aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.

## **Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë**

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit Gj. M., avokati Egzon Qovanaj nga P., për shkak të shkeljes së ligjit penal, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, ta aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të anulohen aktgjykimet e kundërshtuara dhe çështja të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

## **Mendimi i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit**

Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit e Kosovës, me shkresën KMLP.II.nr.171/2024 e datës 23.05.2024 ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.

## **Pretendimet e paraqitura në kërkesë**

Në kërkesë mbrojtësi i të dënuarit thekson se aktgjykimet e kundërshtuara janë marrë me shkelje të ligjit penal, meqë gjykata e shkallës së parë nuk ka marrë parasysh rrethanat lehtësuese që do të ndikonin në zbutjen e dënimit të shqiptuar. Gjykata e shkallës së parë ka marrë për bazë rrethanat lehtësuese të pranimit të fajësisë, bashkëpunimin vullnetar të të dënuarit, sjelljen e mirë të tij. Mirëpo nuk ka vlerësuar rrethanat personale të të dënuarit se i njëjti është i martuar dhe

jeton në bashkësi familjare me bashkëshorten e tij dhe dy fëmijë, pendimin e tij dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra tjera penale.

Pretendohet se gjykata e shkallës së parë është dashur të i kushtoj kujdes lartësisë së dënimit ngase dënimi pos faktit që ka karakter ndëshkues, gjithashtu ka edhe karakter edukues dhe parandalues e po ashtu edhe karakter human, andaj po të kishte parasysh të gjitha këto rrethana do të shqiptonte dënim më të butë.

### **Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës**

Gjykata Supreme e Kosovës në seancën e kolegjit shqyrtoi shkresat e lëndës në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe pas vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se:

- kërkesa nuk është e bazuar.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e mbrojtësit të të dënuarit janë të pabazuara, ngase aktgjykimet kundër të cilave është parashtruar kërkesa, nuk përmbajnë shkelje për të cilat pretendohet.

Duke vlerësuar pretendimet përkitazi me vlerësimin e rrethanave me rastin e shqiptimit të dënimit, Gjykata Supreme e Kosovës vëren faktin se në mënyrë të drejtë është zbatuar ligji penal nga të dy gjykatat e instancave më të ulëta dhe të dënuarit i është shqiptuar dënimi i përcaktuar brenda kornizës së minimumit dhe maksimumit të dënimeve të përcaktuara për veprat penale për të cilat i dënuari është shpallur fajtor. Megjithatë, bazuar në dispozitën e nenit 385 par.5 të KPP-së kur është fjala për vendimin për dënim, dënim alternativ, vërejtje gjyqësore ose në marrjen e vendimit për masën e trajtimit të detyrueshëm për rehabilitim apo për konfiskim të dobisë pasurore të fituar me veprën penale, shkelja e ligjit penal bëhet në rastet kur në marrjen e vendimit për dënim gjykata i ka tejkalluar kompetencat ligjore. Pra, nuk është në kompetencë të Gjykatës Supreme të Kosovës shqyrtimi i lartësisë së dënimit të shqiptuar, por e rëndësishme është se me rastin e shqiptimit të dënimit nuk janë tejkalluar kompetencat ligjore dhe arsyet e dhëna për vendimin për dënim, nuk janë të përfshira në shkelje procedurale. Për më tepër, në faqen e tretë të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë është çmuar si rrethanë lehtësuese fakti i pranimit të fajësisë nga ana e të dënuarit, por edhe rrethana tjera, mirëpo gjithashtu janë

vlerësuar edhe rrethanat rënduese dhe posaçërisht fakti se i dënuari edhe më herët kishte kryer vepra tjera penale. Megjithatë konstatimet e theksuara në aktgjykimet e gjykatave të instancave më të ulëta gjyqësore përkitazi me rrethanat lehtësuese dhe rënduese dhe qëllimin e dënimit të shqiptuar i aprovon në tërësi edhe kjo gjykatë.

Nga sa u parashtrua më lartë e në kuptim të nenit 437 par.1 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË**

Pml.nr.300/2024, më 29 maj 2024

B.profesional,  
Bujar Balaj

Kryetari i kolegjit,  
Afrim Shala